



Pranuar / Dorezuar Prilbena/Prodato Received/Delivered	19	12	2022	2	viti god year
Organ / Njesia Organ / Jedinita Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shitja e Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity		
SKPMSTK	8219	/2022	1/5		



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.934/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Jeton Koca-kryetar, Eshref Shabani dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtarë, me Zyle Millaku Gojnovci-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.934/2022 të datës 20.10.2022 të parashtruar nga ankuesi [redacted] përmes përfaqësuesit të autorizuar Av. [redacted] me adresë: [redacted] Republika e Kosovës, kundër organit të punësimit/*Komuna e Gjilanit*, në çështjen juridike "*Përfundim i marrëdhënies se punës*", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3, nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 19.12.2022, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pa bazuar ankesa A.nr.934/2022 e datës 20.10.2022 e parashtruar nga ankuesi.

II. Mbetet në fuqi Vendimi numër 987 i datës 23.09.2022 i Kryetarit të Komunës së Gjilanit.

A r s y e t i m

Ankuesi, [redacted] i punësuar në pozitën e punës Operator i të dhënave në Drejtorinë për Buxhet dhe Financa në kuadër të Komunës së Gjilanit, me datë 20.10.2022 përmes përfaqësuesit të autorizuar Av. [redacted] ka parashtruar ankesë me numër protokolli 6342/2022 të regjistruar nën shenjen A.nr.934/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit numër 987 të datës 23.09.2022 të Kryetarit të Komunës së Gjilanit, lidhur me përfundimin e marrëdhënies se

punës, me pretendimin ankimor se vendimi i kontestuar është nxjerr në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ngase në bazë të nenit 90 paragrafi 2 nën paragrafi 2.4 të këtij ligji si kusht për përfundimin e marrëdhënies se punës parashihet mbajtja e burgut efektiv, për çka në rastin konkret kjo kondite ligjore nuk është plotësuar sepse ankuesit dënimi me burg i është zëvendësuar me dënim me të holla, dënim ky që do t'i mundësonte të njëjtit pjesëmarrjen e rregullt në punë, pa asnjë pengesë në asnjë formë. Tutje, përfaqësuesi i autorizuar i ankuesit me datë 21.11.2022, përmes shkresës me numër protokoll 7254/2022 ka plotësuar ankesën e datës 20.10.2022, duke pretenduar se Vendimi me numër protokoll 987 i datës 23.09.2022 është nxjerr mbi bazën juridike të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës, i cili Ligj nuk ka fuqi juridike, që nga viti 2019 kur edhe është abroguar nga Ligji Nr.06/L-114 për Zyratet Publike, dhe se i njëjti pretendon se vendimi i kontestuar është i padrejte dhe i paligjshëm meqenëse është i bazuar në dispozita të shfuqizuara siç është Ligji për Shërbimin Civil, dhe jo në ligjin adekuat - në fuqi Ligjin për Zyratet Publike, rrjedhimisht ankuesi pretendon se vendimi i kontestuar është nxjerr në kundërshtim me dispozitat e nenit 60 paragrafi 1 nën paragrafi 1.6 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyratet Publike.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, me datë 28.10.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të Komuna e Gjilanit, ndërsa me datë 14.11.2022 ka pranuar përgjigjen në ankesë së bashku me provat e bashkangjitura të lëndës.

Kryetari i Këshillit, në mbështetje të nenit 17 paragrafi 2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 02.12.2022 me Vendimin VK.nr.180/2022 ka vazhduar afatin e vendimmarrjes edhe për dhjetë (10) ditë pune për ankesën me numër Anr.934/2022 të datë 20.10.2022.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave administroi këto prova: Ankesën me numër protokoll 6342/2022 të regjistruar nën shenjën A.nr.934/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Shkresën me protokoll 7254/2022 të datës 21.11.2022 për plotësimin e ankesës të datës 20.10.2022; Autorizimin e dhënë përfaqësuesit të autorizuar Av. Vendimin Nr.02/987 të datës 23.09.2022, të Kryetarit të Komunës së Gjilanit; Përgjigjen në ankesë të datës 14.11.2022 me pliko-R2651112- postes së Kosovës të datës 10.11.2022; Akt emërimit të datës 22.07.2011; Kërkesën e datës 09.09.2019 nga Policia e Kosovës; Vendimin Nr.789 të datës 10.09.2019 të Kryetarit të Komunës së Gjilanit, me flete dorëzim të datës 12.09.2019; Letrën përcjellëse të datës 11.09.2019; Kërkesë nr.791 të datës 10.09.2019, me flete dorëzim të datës 23.09.2023; Shkresën e datës 22.10.2019 nr. 1027; Njoftimin nr.40/2019 të datës 23.10.2019 të lëshuar nga Zyra e Kryetarit të Gjilanit; Formularin e datës 08.10.2019; Ankesën e datës 08.10.2019 për shfuqizimin e vendimit për pezullim parandalues, nga përfaqësuesi i autorizuar i ankuesit drejtuar Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Njoftimin e datës 28.10.2019 i protokolluar me nr.02-016-126422/2; Kërkesën me numër protokoll 5627/2019 të datës 27.11.2019 nga KPMSHCK, me Ankesë e datës 22.11.2019 për shfuqizimin e vendimit të pezullimit parandalues dhe pliko postare e datës 02.12.2019 nga Menaxheri i personelit të Komunës së Gjilanit; Përgjigjen e datës 06.12.2019 nga Komuna

e Gjilanit për KPMSHCK; Aktgjykimin PKP.Nr.185/2019 të datës 01.12.2021 të Gjykatës Themelore në Gjilan-Departamentin për Krime të Rënda, i plotfuqishëm me datë 21.02.2022.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar dhe analizuar shkresat e bashkangjitura të lëndës konstatoi se ankesa e ankuesit, është e pa bazuar sepse:

Nga administrimi i shkresave të lëndës, rezulton se ankuesi sipas Aktit të Emërimit me numër protokollit 16-19855 të datës 22.07.2011 ka qenë i emëruar për kohë të pacaktuar (përhershme) në pozitën e punës *Operator i të Dhënave* në Drejtorinë për Buxhet dhe Financa në kuadër të Komunës së Gjilanit.

Tutje, bazuar në shkresat e administruara të lëndës është konstatuar Kryetari i Komunës së Gjilanit, duke u bazuar në dispozitat e nenit 69 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1, 1.2 dhe 1.3 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës, me Vendimin me numër protokollit 784 të datës 10.09.2019 kishte pezulluar nga marrëdhënia e punës ankuesin me arsyetimin se ndaj të njëjtit kishte filluar procedure penale nën dyshimin e kryerjes së veprës penale "Keqpërdorim i Pozitës apo Autoritetit Zyrtar" nga neni 422 i KPRK-së.

Rrjedhimisht, me datë 23.09.2022, organi përkatës i punësimit ka nxjerr Vendimin me numër protokollit 987 të datës 23.09.2022 lidhur me përfundimin e marrëdhënies së punës për ankuesin me arsyetimin se ankuesi sipas Aktgjykimit PKR. Nr.185/2019 të datës 21.02.2022 (i plotfuqishëm) të Gjykatës Themelore në Gjilan - Departamenti për Krime të Rënda, është shpallur fajtor dhe është gjykuar me dënim me burg prej 180 ditë - gjashtë muaj, i cili dënim me pëlqimin e të akuzuarit është zëvendësuar me dënim me gjobë në shumë prej pesë mijë (5000) euro, dhe dënim plotësues Ndalim i Ushtrimit të Funksioneve në Administratë Publike ose në Shërbimin Publikë, prej dy (2) vite pas plotfuqishmërisë së Aktgjykimit.

Lidhur me pretendimin ankimor të ankuesit se organi përkatës i punësimit, gjegjësisht Kryetari i Komunës së Gjilanit gabimisht ka aplikuar ligjin material në këtë çështje juridiko-administrative, duke aplikuar Ligjin Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil, dhe jo Ligjin Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, Kolegji i Këshillit analizoi aktin e kontestuar me ankesë, gjegjësisht Vendimin me numër protokollit 987 të datës 23.09.2022 dhe rrjedhimisht duke ju referuar edhe shkresave të administruara të lëndës konstatoi se pretendimi ankimor i ankuesit si i tillë është i pa bazuar ngase sipas shkresave të administruara të lëndës është vërtetuar se ankuesi ishte pezulluar nga marrëdhënia e punës me datë 10.09.2019, në kohën e aplikimit të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil, dhe se e njëjta procedurë duhej të përfundonte sipas dispozitave të këtij Ligjit, konstatim ky në frymën e Ligjit Nr.06/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përkatësisht nenit 157 ku përcaktohet se: *Procedurat administrative të filluara dhe të papërfunduara në datën e hyrjes në fuqi të këtij Ligji, do të vazhdojnë sipas dispozitave të mëparshme ligjore, që kanë rregulluar procedurën administrative.*

Kolegji i Këshillit nga analizimi i dispozitave të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, gjegjësisht nenin 90 të këtij ligji, konstatoi se pretendimet ankimore të ankuesit për shkelje të ligjit material, si dhe vërtetim të gabuar dhe jo të plotë

të gjendjes faktike janë të pa bazuara sepse nga analizimi i Aktgjykimit PKR. Nr.185/2019 të datës 21.02.2022 (i plotfuqishëm) të Gjykatës Themelore në Gjilan-Departamenti për Krime të Renda, rrjedh se ankuesi është shpallur fajtor për vepër penale "Falsifikim i Dokumenteve Zyrtare" nga neni 427 paragrafi 1 lidhur me nenin 77 paragrafi 1.2, 1.4 dhe 1.5 të KPRK-së, dhe rrjedhimisht i njëjti është gjykuar me dënim me burg prej 180 ditë - gjashtë muaj, i cili dënim me pëlqimin e të akuzuarit është zëvendësuar me dënim me gjobë në shumë prej pesëmijë (5000) euro, dhe dënim plotësues *Ndalim i Ushtrimit të Funksioneve në Administratë Publike ose në Shërbimin Publikë, prej dy (2) vite pas plotfuqishmërisë se Aktgjykimit*, kështu që në vlerësimin e Kolegjit të Këshillit organi përkatës i punësimit me rastin e nxjerrjes së vendimit për përfundimin e marrëdhënies së punës për ankuesin ka vërtetuar drejt gjendjen faktike dhe rrjedhimisht drejtë ka zbatuar ligjin material ngase ankuesi është dënuar përveç dënimit me burg i cili i është zëvendësuar me dënim me gjobë, edhe me dënim plotësues *Ndalim i Ushtrimit të Funksioneve në Administratë Publike ose në Shërbimin Publikë, prej dy (2) vite*, dhe se organi i punësimit ka pritur për përfundimin e marrëdhënies së punës të ankuesit deri sa aktgjykimi dënuës është bërë i plotfuqishëm.

Ndërsa, në kuptim të vlerësimit të rrethanave lidhur me aplikimin e ligjit me të favorshëm për ankuesin, Kolegji i Këshillit në mbështetje të nenit 86 paragrafi 1 të Ligjit Nr.06/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, analizoi dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtaret Publikë, përkatësisht nenin 60 të këtij ligji me të cilin rregullohet çështja e përfundimit të marrëdhënies së punës për shkak të ligjit, dhe si rrjedhojë konstatoi se dispozitat e këtij ligji nuk janë me të favorshme për ankuesin ngase edhe me dispozitat e nenit 60 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 parashihet se marrëdhënia e punës në Shërbimin Civil përfundon kur nëpunësi civil dënohet me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje.

Andaj, për sa me sipër dhe duke marr parasysh faktin se ankuesi me Aktgjykimin PKR. Nr.185/2019 të datës 21.02.2022 (i plotfuqishëm) të Gjykatës Themelore në Gjilan-Departamenti për Krime të Renda, është shpallur fajtor për vepër penale "Falsifikim i Dokumenteve Zyrtare" nga neni 427 paragrafi 1 lidhur me nenin 77 paragrafi 1.2, 1.4 dhe 1.5 të KPRK-së, dhe rrjedhimisht i njëjti është gjykuar me dënim me burg prej 180 ditë - gjashtë muaj, i cili dënim me pëlqimin e të akuzuarit është zëvendësuar me dënim me gjobë në shumë prej pesëmijë (5000) euro, dhe dënim plotësues *Ndalim i Ushtrimit të Funksioneve në Administratë Publike ose në Shërbimin Publikë, prej dy (2) vite pas plotfuqishmërisë se Aktgjykimit*, Kolegji i Këshillit konstaton se pretendimet ankimore lidhur me shkeljen e ligjit material, si dhe vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, me rastin e përfundimit të marrëdhënies së punës të ankuesit, janë të pa bazuara, ndërsa Vendimi me numër protokolli 987 i datës 23.10.2022 për përfundimin e marrëdhënies së punës të ankuesit, në vlerësimin e Kolegjit të Këshillit është i drejt dhe i ligjshëm.

Kështu që pas analizimit dhe vlerësimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në dispozitat e nenit 6 paragrafi 1 nën paragrafin 1.1, nenit 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenit 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.06/L-031 për

Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.934/2022

Zyle Millaku Gojnovci

Procesmbajtëse



Vendimi i dërgohet:

- Përfaqësuesit të autorizuar A. [REDACTED]
- Kryetarit të Komunës së Gjilanit;
- Menaxherit të Personelit në Komunën e Gjilanit; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së